

STATUTI

I SHOQËRISË "GJERGJEFI" PËR PRODHIM VESHJESEH EKSPORT IMPORT ME SELI NË QYTETIN E BILISHTIT SH.P.K.

Ortaku i vetëm JANI DIMITRAQ GJERGJEFI, datl. 1960, banues në Bilisht, ka themeluar shoqërinë prodhuese e tregëtare me përgjegjësi të kufizuar "GJERGJEFI" SH.P.K. me seli në qytetin e Korce, e cila do të funksionojë sipas këtij statuti.

I. Dispozita të përgjithëshme

Neni 1

Themelohet në qytetin e Bilishtit shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "GJERGJEFI" me ortak të: vetëm.

Neni 2: Selia e shoqërisë do të jetë në qytetin e ~~Korce~~ Bilishtit ish N.P. Veshjeve Nr.1.

Neni 3: Shoqëria ka të drejtë të paraqitet në qarkullimin civil e merr të drejta e detyrime mbasi regjistrohet në regjistrin tregëtar të Gjykatës së RRETHIT TIRANË dhe të marrë lejën përkatëse për ushtrim profesional.

Neni 4: Qendra e shoqërisë është në qytetin e ~~Bilish~~ Ajo ka të drejtë të hapë filiale në të gjitha njësitë territoriale të Republikës së Shqipërisë e jashtë saj.

Agjensitë e filialeve krijohen në bazë të legjislacionit të vendit ku ato hapen.

Neni 5:

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë do të jetë: Prodhim i veshjeve të të gjitha llojeve e për të gjitha moshat vetë ose me porosi të materialporositësit, shitja e prodhimeve të gatshme në vend ose jashtë shtetit, blerja e lëndëve të para e ndihmëse për prodhim veshjesh brënda dhe jashtë vendit, tregëti me shumicë e pakicë e tyre.

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë mund të shtohet me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 6: Veprimtaria e shoqërisë së të zhvillohet në pajtim me këtë statut dhe normat ligjore juridike civile, administrative, fiskale, e doganore të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mban përgjegjësi për detyrimet që lindin me subjektet e tjera juridike apo fizike ~~me~~, përgjigjet me pasurinë e saj. Në rastet kur kapitali është i pamjaftueshëm ortakut i vetëm vendos shtimin e tij duke derdhur kapital plotësues.

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 15 vjet.

Neni 8

Shoqëria ka të drejtë të krijojë lidhje të tjera ortakërie ose shoqëri të përbashkëta në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj, duke hartuar edhe statutin përkatës.

Neni 9: Shoqëria ka vulën e saj ku do jetë e shkruar shoqëria prodhuese e tregëtare SH.P.K e në mes të saj "Gjergje fi".

~~XXXXXXXXXX~~

II. KUSHTET EKONOMIKE

Neni 10

Veprimtaria e shoqërisë bazohet në kushtet e ekonomisë së

-1-

pregut duke patur qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e likuiditetit, sigurisë etj/

Neni 11. Shoqëria e ushtron veprimtarinë në bazë të parimeve të llogarisë dhe mban për këtë qëllim bilancin e saj.

Neni 12: Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000.000 lek dhe i përket tërësisht ortakut të vetëm.

Neni 13:

Capitali themeltar është lirisht i transferushëm me akte midis të gjallëve dhe trashgimtarëve ligjorë e testamentarë, vetëm me miratim të Ortakut të vetëm.

Neni 14: Ortaku i vetëm ka të drejtë të vendosë për shtimin ose pakësimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 15: Shoqëria është pronare e pasurive të luajtshme dhe të palujtë shme të cilat mund të përdoren sipas qëllimit dhe destinacionit të veprimtarisë së saj. Shoqëria mund të blejë pasuri të tjera dhe mund të lërë peng ose ipotekë pasurinë e saj kur cmohet e nevojshme nga ortakut i vetëm.

Neni 16: Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera për financimin e veprimtarisë së saj. Ajo disponon lirisht këto fonde për plotësimin e detyrimeve që lindin në zhvillimin e veprimtarisë së saj dhe po që e nevojshme detyrimet i shlyen edhe me shumat suplementare që jepen vetëm nga ortakut themelues.

Neni 17: Fitimi i realizuar nga veprimtaria e shoqërisë i takon tërësisht ortakut themelues i cili disponon atë lirisht.

III .ADMINISTRIMI

Neni 18 :

Asamblea si organ i vetëm vendimor i shoqërisë përfaqësohet nga ortakut i vetëm. Vendimet e marra prej tij në harmoni me dispozitat e këtij statuti dhe legjisllacionit përkatës të Rep.e shqipërisë janë të detyrueshme për gjithë të punësuarit.

Neni 19 : Asamblea thirret rregullisht një herë në tre muaj .

Neni 20: Ortaku i vetëm ka të drejtë të autorizojë me prokurë çdo person tjetër të drejtojë dhe shqyrtojë materialet e mbledhjes së Asamblesë.

Për drejtimin e mbledhjes caktohet një sekretar i cili pasqyron në procesverbalin përkatës vendimet e marra, të cilat konfirmohen nga ortakut i vetëm.

Neni 21 : Shoqëria administrohet nga një administrator që është ortakut i vetëm ose nga një drejtor i zgjedhur prej tij. Drejtori mund të shkarkohet nga kjo detyrë mbasi të jetë paralajmëruar më parë.

Neni 22: Drejtori është organ administrativ i shoqërisë dhe paraqitet me këtë cilësi para çdo organi shtetëror administrativ e gjyqësor. Ai kryen të gjitha veprimet e nevojshme për drejtimin e shoqërisë, me përjashtim të atyre që ky statut i ngrakon ortakut të vetëm.

Neni 23 : Drejtori kapër detyrë të paraqesë propozimet e nevojshme tek ortakut i vetëm për të gjitha problemet e shoqërisë duke rezezruar edhe iniciativën që të propozojë ndryshime në statut.

IV. BILANCI DHE TË ARDHURAT:

Neni 24:

Veprimtaria financiare mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të vitit ortakut i vetëm ose drejtori procedon në llogaritjen e bilancit të llogarisë fitim humbje, sipas dispozitave ligjore. Mbledhja për aprovimin e bilancit bëhet jo më vonë se tre muaj pasi mbyllet llogaria.

Neni 25. Fitimi i realizuar, mbasi xhirohet një shumë jo më e vogël se 5% si fond rezervë tërhiqet prej ortakut të vetëm. Ortaku i vetëm ka të drejtë të marrë vendime për shtimin e fondit rezervë për investime për destinacion në favor të drejtorit ose punonjësve të tjerë të shoqërisë, si dhe për veprime bamirësie.

Neni 26: Pagesat do të bëhen në Bankën _____ dega Bilisht në Nr. _____ logarie. të drejtën e firmës e ka ortakut i vetëm dhe me miratimin e tij edhe drejtori i saj.

V. MARDHËNIET E PUNËS

Neni 27:

Shoqëria do të punësojë puntorë dhe personel drejtues administrativ. Mardhëniet e punës do të rregullohen me këtë statut dhe sipas ligjës "për mardhëniet e punës" në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Punësimi i punonjësve do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale të punës ku përcaktohet:

Kushtet dhe mënyra e kryerjes së punës

Koha e fillimit të punës dhe profesioni i të punësuarit

Koha e punës, puna me ndresa, puna jashtë kohës normale, puna në ditët e pushimit javor e festave zyrtare dhe shpërblimi i të punësuarit në këto ditë.

Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës

Pushimet dhe mangesat, të drejtat, detyrimet e përgjegjësinë e të punësuarit për dëmet e shkaktuara gjatë mardhënieve të punës.

Pushimi i mardhënieve të punës

"aga, shpërblimet e punës dhe shpërblimet e tjera të të punësuarit.

VI. MBYLLJA E SHOQËRISË LIKUJDIMI

Neni 29

Shoqëria përfundon veprimtarinë e saj me plotësimin e parashi kuar në kontratë. Ortaku i vetëm mund të vendosë për prishjen e shoqërisë dhe para përfundimit të afatit. Prishja e shoqërisë vendoset edhe nga ana e gjykatës në kushtet e parashikuara nga ligja.

Neni 30

Ortakut i vetëm cakton likuidimin e shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë, të cilëve u përcakton edhe fuqinë.

Likuidatori ka për detyrë të realizojë likuidimin e shoqërisë. Me marjen e vendimit të likuidimit shoqëria shton për bri emrit të saj shënimin "Shoqëri në likuidim e sipërm".

Neni 31: Njoftimi i mbylljes së likuidimit të shoqërisë do të publikohet në një gazetë të caktuar për këtë qëllim dhe shoqëria cre gjistohet nga regjistri tregëtar.

VII. Dispozita e fundit

Neni 32: Statuti i shoqërisë "Gjergjeji" SNEK u nënshkrua nga ortakut i vetëm sot më datën 2.2.1994, para noterit Korce s.

ORTAKU THEMELUES: JANI GJERGJEJI